



Primitur / Dohetuzua Received / Primito Received / Dohetuzua	18.01	2024	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednostka Organi / Unitet	SKPMST/CK	318/2024	Sasia Kolicina Quantity
			1/4



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**A.nr.1437/2023**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1437/2023 të datës 23.11.2023, të parashtruar nga ankuesi me adrese banimi: Lagjja, Kodrina "Tregtia" Blloku R9, Hy 1, Nr.19, në Matiqan, Komuna e Prishtinës, kundër Raportit të Komisionit për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimin me Rëndësi Strategjike i miratuar sipas Vendimit Nr.23/165 të datës 12.10.2023 të Qeverisë së Kosovës, në çështjen juridike "Kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 18.01.2024, mori këtë:**

**V E N D I M**

**Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.1437/2023 e datës 23.11.2023 e parashtruar nga ankuesi**

**A r s y e t i m**

**Ankuesi i punësuar në pozitën "Administrator i Lartë Teknologjisë Informative për Sisteme" në Shërbimin Korrektues të Kosovës, me datë 23.11.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 7070/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, e regjistruar nën shenjë A.nr.1437/2023, kundër Raportit të Komisionit për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimin me Rëndësi Strategjike i miratuar sipas Vendimit Nr.23/165 të datës 12.10.2023 të Qeverisë së Kosovës, lidhur me aprovimin e listës së eksperteve sipas shtojcës 14.4 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik., gjegjësisht kundër klasifikimit në klasën B5.**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 06.12.2023, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komisionin për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të**

Informacionit dhe Komunikimin me Rëndësi Strategjike, ndërsa, ky i fundit, me datë 11.12.2023, ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me provat materiale lidhur me këtë çështje.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankueses, është e parakohshme, sepse:

Nga shkresat e lëndës, Kolegji ka gjetur se Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendimin Nr.07/132 të datës 08.03.2023, ka themeluar Komisionin për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimet me Rëndësi Strategjike, përgjegjës për shqyrtimin e kërkesave të dërguara nga institucionet që kanë të bëjnë me sistemin shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike sipas Rregullores Nr.11/2023 për Ekspertët dhe dërgimin në Qeveri, të listës së Eksperteve, të kategorizuar në shtojcën 14.4 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.

Komisioni për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimet me Rëndësi Strategjike, ka përgatit Raportin e punës, listën e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimeve me rëndësi strategjike dhe listën e pozitave të eksperteve sipas shtojcës 14.4 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, të cilat janë miratuar nga Qeveria e Kosovës, me Vendimin Nr.23/165 të datës 12.10.2023.

Duke qenë se Shërbimi Korrektues i Kosovës tek Komisioni për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimet me Rëndësi Strategjike ka propozuar *Sistemin Elektronik të Menaxhimit të Burgosurve(SIMB)*, kurse Komisioni për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimet me Rëndësi Strategjike sipas raportit të punës nuk e ka pranuar si sistem shtetëror me rëndësi strategjike, përkatësisht Shërbimit Korrektues të Kosovës nuk i është pranuar asnjë sistem i kësaj natyre, ndërsa me datë 16.10.2023 Shërbimi Korrektues i Kosovës përmes Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm ka parashtruar kërkesë për rishqyrtimin e kërkesës së datës 15.03.2023 lidhur me përfshirjen e Sistemit të Menaxhimit të Burgosurve në sisteme shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike, tek Komisioni për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimet me Rëndësi Strategjike, mirëpo sipas provave të lëndës ende nuk është rishqyrtuar kërkesa.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, pretendon se duke marr parasysh natyrën e punës së Shërbimit Korrektues të Kosovës, është dashur të përfshihet *Sistemi Elektronik i Menaxhimit të Burgosurve(SIMB)* në sisteme në kuadër të Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimet me Rëndësi Strategjike, nga se sipas saj ky sistem është i ndërlidhur me Këshillin Gjyqësor, Këshillin Prokurorial, Policinë e Kosovës, Agjencinë e Regjistrimit Civil, Ministrinë e Drejtësisë, ILECU, AKI, pra Shërbimi Korrektues i Kosovës me këto Institucione merr dhe jep informacione të ndjeshme, andaj përveç këtij sistemi edhe pozita sipas pretendimit të tij duhet të kualifikohet si ekspert 5,klasa B5,koeficienti 12 i përcaktuar në shtojcën 14.4 të Ligjit Nr.08/196 për Pagat në Sektorin Publik.

Kolegji i Këshillit, konstaton se Komisioni për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimet me Rëndësi Strategjike përmes përgjigjes në ankesë të datës 11.12.2023, ka njoftuar që më datë 17.10.2023 ka pranuar kërkesën nga Shërbimi Korrektues i Kosovës për rishqyrtim të kërkesës paraprake të datës 15.03.2023, duke njoftuar që Komisioni është duke shqyrtuar këtë çështje.

Duke marr parasysh dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht neni 98 paragrafi 1 dhe 2, përcakton se: "1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj", atëherë nëse çështja e shqyrtimit të kërkesës nuk mund të bëhet brenda këtij afati për shkak të rrethanave të parashikuara me nenin 99 të këtij ligji, atëherë organi publik që shqyrton kërkesën mund të shtyj afatin për shqyrtimin e saj siç parashihet me paragrafin 1 dhe 2 të nenin 99 të këtij ligji i cili përcakton se: "1. Përveç kur ndalohet shprehimisht me ligji, nëse është e nevojshme për shkak të kompleksitetit të çështjes administrative konkrete, organi publik mund të shtyjë, vetëm një herë, afatin fillestar të paraparë për përfundimin e procedurës administrative, sipas nenit 98 të këtij Ligji. 2. Shtyrja sipas paragrafit 1 të këtij neni, do të bëhet për aq kohë sa është e nevojshme për të përfunduar procedurën administrative dhe duhet të jetë në përpjesëtim me kompleksitetin e çështjes konkrete, por nuk mund të jetë më e gjatë se afati fillestar".

Andaj Kolegji i Këshillit, konstaton se meqenëse Institucioni në këtë rast Shërbimi Korrektues i Kosovës ka parashtruar kërkesën te komisioni përkatës për rishqyrtim të kërkesës së datës 16.10.2023 me nr.pro.1268 që ndërlidhet me këtë ankesë, ndërsa ankesa në Këshill është dorëzuar më datë 23.11.2023, duke pasuar parasysh dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht neni 98 paragrafi 1 dhe 2, dhe se kërkesa e Shërbimit Korrektues të Kosovës është në fazën shqyrtimit nga Komisioni për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimet më Rëndësi Strategjike, atëherë ankesa e ankueses është e parakohshme në kuptim të nenit 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ngase nuk janë plotësuar kushtet ligjore për shqyrtimin në mënyrë meritore të ankesës së ankuesit pasi që nuk ka kaluar afati i përcaktuar kohor për shqyrtimin e kërkesës së datës 16.10.2023 të SHKK-së nga komisioni përkatës, kështu që Kolegji në mbështetje të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, konstaton se ankesa e parashtruar nga ankuesi është e parakohshme, sepse përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: "heshtja administrative"), siç parashihet me nenin 125 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrativ, ngase Komisioni për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimet më Rëndësi Strategjike ka deklaruar se është duke e shqyrtuar kërkesën datës 16.10.2023.

Kolegji i Këshillit pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda me numër A.nr.1437/2023

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit
- Komisionit për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimet më Rëndësi Strategjike/Qeveria e Kosovës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës ;dhe
- Arkivit të KPMSHCK -së.

